



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3079/9 prot.

Datë 08.05.2026

V E N D I M
Nr. 616/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2026 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1871/2025, datë 17.12.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK, me Nipt. M51901012F dhe adresë Vaqarr, Magazine 1 katëshe, mbas kështjellës Konti, Zona Kadastrale 3712, Numer pasurie 18/54, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 17.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1871/2025, ku vendosi:

“[...]

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh., parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]”

I.2. Me shkresën nr. 1666 prot., datë 04.05.2026 me objekt “Lidhur me zbatimin e Vendimit të KPP-së nr.1871/2025, datë 17.12.2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, protokolluar me tonën nr. 3079/6 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë njofton se autoriteti kontraktor, njofton se:

“...për shkak të një gabimi njerëzor, gjatë fazës së heqjes nga pezullimi të një procedure tjetër në proces ankimimi, procedura e prokurimit me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri” ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave. Duke qenë se data e hapjes/zhvillimit të kësaj procedure ka qenë 03.11.2025, ora 16:00 nuk është bërë i mundur ngarkimi në sistemin e prokurimit elektronik, të modifikimit të dokumenteve të tenderit, pasi procedura ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor nuk mundet të pasqyrojë në sistemin e prokurimit elektronik modifikimet e bëra të dokumentave të tenderit, si dhe as operatorët ekonomi ofertues nuk kanë mundësi të njihen me to.

Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit të sipërcituar në mënyrë që të vijohet me hapat për anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ju bëjmë me dije se në rishpalljen e procedurës së prokurimit të objektit “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, autoriteti Kontraktor të hartojë specifikimet teknike në përputhje me vendimin nr.1871/2025, datë 17.12.2025 të KPP”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1666 prot., datë 04.05.2026 me objekt “Lidhur me zbatimin e Vendimit të KPP-së nr.1871/2025, datë 17.12.2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, protokolluar me tonën nr. 3079/6 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë njofton se autoriteti kontraktor, njofton se:

“...për shkak të një gabimi njerëzor, gjatë fazës së heqjes nga pezullimi të një procedure tjetër në process ankimimi, procedura e prokurimit me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri” ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave. Duke qenë se data e hapjes/zhvillimit të kësaj procedure ka qenë 03.11.2025, ora 16:00 nuk është bërë i mundur ngarkimi në sistemin e prokurimit elektronik, të modifikimit të dokumenteve të tenderit, pasi procedura ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor nuk mundet të pasqyrojë në sistemin e prokurimit elektronik modifikimet e bëra të dokumentave të tenderit, si dhe as operatorët ekonomi ofertues nuk kanë mundësi të njihen me to.

Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit të sipërcituar në mënyrë që të vijohet me hapat për anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ju bëjmë me dije se në rishpalljen e procedurës së prokurimit të objektit “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, autoriteti Kontraktor të hartojë specifikimet teknike në përputhje me vendimin nr.1871/2025, datë 17.12.2025 të KPP”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ndodhet në pamundësi për të zbatuar vendimin nr.1871/2025 datë 17.12.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik. Për të vijuar me vazhdimin e procedurës dhe njëkohësisht për zbatimin e e vendimit nr. 1871/2025 datë 17.12.2025 të KPP kërkohet anulimi i kësaj procedure por ndërkohë autoriteti kontraktor, nuk ka dërguar shtojcën me modifikimet e dokumentave të tenderit sipas konstatimeve të vendimit të sipërcituar të KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të dërgojë brenda 5 ditëve pranë KPP dokumentat e procedurës që do të rishmallë ku të jenë pasqyruar ndryshimet sipas vendimit nr.1871/2025 datë 17.12.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe Formulimin e Njoftimit të Anullimit të procedurës së sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

